



REPUBLIKA E SHQIPERISE

KESHILLI I BASHKISE LUSHNJE

KOMISIONI JURIDIK RENDIT DHE SITUATAVE EMERGJENETE



Lushnje me 26/09 /2024

Nr 7726

-Lënda: Konsultim publik me teme: Per miratimin e dokordesise ne dhenien me qira te pasurise me nr.23,zona kadastrale,1428,fshati Çukas i Ri ,Njesia Administrative Allkaj.

-Baza ligjore; Ligji nr 139/2015,“Per veteqeverisjen vendore” vendore” neni 18 ,54, ligji nr 146/2014”Per njoftimin dhe konsultimin publik,rregullorja nr 36 date 24.04.2020”Mbi marrredheniet e keshillit me publikun dhe median.(konsultimeve).

Propozuesi: Komisioni Juridik ,Rendit dhe Situatave Emergjente.

Sqarime: Në inventarin e pronave te paluajtshme shtetërore të miratuara me VKM-në nr. 855, datë 04.12.2012 “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen, në pronësi ose në përdorim, të Komunës Allkaj të Qarkut të Fierit”, sot Njësia Administrative Allkaj, Bashkia Lushnje, pasuria me nr. rendor 190 është e transferuar në pronësi sipas lidhjes nr. 1, me emërtim “tokë bujqësore”, inproduktive, Vendndodhja Komuna Allkaj, Komponentet përberes të pronës është Tokë e pafrytshme, Adresa: Çukas i Ri, me sipërfaqe totale 28594 m², Fusha e përdorimit të pronës është Bujqësi dhe Ushqim, Institucioni/Enti me përgjegjësi administrative është **Ministria e Bujqësisë dhe Ushqimit dhe Institucioni/Enti përdorues është Drejtoria e Bujqësisë dhe Ushqimit Lushnje.**

Pasuria me nr. rendor 190 është e transferuar në klasë, pa numër pasurie. Për këtë arsye, bashkia i ka kërkuar informacion të detajuar Drejtorisë së Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës Fier. Me shkresën nr. 650/1 prot. datë 22.06.2003, Drejtoria e Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës Fier informon bashkinë se ngastra nr. 23 me sipërfaqe 3.54 ha, është e resursit “tokë e pafrytshme dell”, ndodhur në fshatin Çukas i Ri, Njësia Administrative Allkaj, Bashkia Lushnje, ku kjo pronë përkon me pasurinë me nr. rendor 190 të inventarit të miratuar me VKM-në nr. 855, datë 04.12.2012.

Me shkresën nr. 7240/1 prot. datë 08.09.2023, bashkia i është drejtuar DVASHK Lushnje për regjistrimin e pasurisë shtetërore nr. 23, ZK. 1428, fshati Çukas i Ri, Njësia Administrative Allkaj në pronësi të Bashkisë Lushnje. Drejtoria Vendore e A.Sh.K-së Lushnje, me datë 29.02.2024 ka dërguar Çertifikatën e pronësisë,

Adresa:Lagjia “Kongresi i Lushnjes” Tel:+355 35 222139 E-mail:bashkia lushnje@yahoo.com

kartelën e pasurisë se paluajtshme dhe fragmentin e hartës kadastrale, me këto të dhëna: pasuria nr. 23, ZK. 1428, në pronësi të Bashkisë Lushnje, me sipërfaqe 28 594 m², e llojit “pa frut”.

Për dhënien me qira për pasurinë e mësipërme, duke u nisur nga fakti që është e llojit pa frut dhe sipas V.K.M-së nr.54 datë 05.02.2014 “Për përcaktimin e kriterëve ,të procedurës dhe mënyrës së dhënies me qera dhe enfiterozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore” të ndryshuar, **Kreu I, pika 6, gërma “c” përcaktohet se “Të drejtën e lidhjes së kontratës së qirasë dhe të përcaktimit të afateve të dhënies me qira e kanë: Ministria përgjegjëse për ekonominë, për tokat e pafrytshme”.**

Si rrjedhojë, me shkresën nr. 6563/1 prot. datë 23.04.2024 bashkia i është drejtuar Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit me propozimin për dhënie me qira të kësaj pasurie. Me shkresën nr. 5229/3 prot. datë 02.08.2024, administruar në Bashkinë Lushnje me nr. 6603 prot. datë 12.08.2024, Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit **kërkon miratimin e organit të varësisë administrative, që në rastin konkret është Këshilli Bashkiak Lushnje.**

-Kalendari i konsultimit:Konsultimi publik do të realizohet në perputhje me kalendarin e konsultimit publik.

-Pjesëmarrës:

-Keshilli –Kryetari i Keshillit, : Komisioni i Juridik Rendit dhe Situatave Emergjente.

,Keshilltare.

-Bashkia:Koordinatori për njoftimin e konsultimit publik,propozuesit e projekt-vendimit nga administrata.

-Komuniteti:Banoret e bashkisë ,te rinj përfaqësues nga shoqëria civile,përfaqësues të biznesit,medias,kryetaret e fshatrave.

-Forma e konsultimit:Takim publik.

-Qëllimi i konsultimit publik:Keshillimi publik synon tërheqjen e mendimit të qytetarëve,biznesit,shoqërisë civile ,te rinjve në lidhje me këtë projekt akt.

-Relacionin dhe projekt vendimin mund të gjeni në web-in e bashkisë ,rubrika keshilli bashkiak ,në faqen e fb-se së keshillit bashkiak Lushnje ,si dhe në këndin e shpalljeve të bashkisë.

-Dita ,data ,ora dhe vendi i takimit publik:Ditën e Marte date 15.10.2024,ora 12:00 në ambientet e lokalit të z.Sokol Thaçi ,fshati Çukas i Ri Njesia Administrative Allkaj.

-Ky njoftim të afishohet në cdo lagje të njesisë administrative perkatëse.

-Ftojme cdo të interesuar të behet pjesë e këtij konsultimi publik,gjithashtu mirepresim cdo sugjerim tuaj si në rrugë postare , elektronike,dhe në cdo formë tjetër.

-Duke ju falenderuar!

KRYETARI

Ledio Gjyla

Adresa:Lagjia “Kongresi i Lushnjes” Tel:+355 35 222139 E-mail:bashkia_lushnje@yahoo.com

